

VENDIM
Nr. 775, datë 30.9.2020

**PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT NGA BASHKIA DURRËS,
MIRATUAR NË BUXHETIN E VITIT 2020, PËR FINANCIMIN E HARTIMIT TË
PROJEKTPREVENTIVIT DHE RIFORCIMIN E HIDROVORIT TË DURRËSIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, dhe 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën prej 51 550 000 (pesëdhjetë e një milionë e pesëqind e pesëdhjetë mijë) lekësh pa TVSH, për financimin e hartimit të projektpreventivit dhe riforcimin e Hidrovorit të Durrësit, të dëmtuar nga tërmeti i datës 26.11.2019.

2. Efekti financiar, sipas pikës 1, të këtij vendimi, përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e shtetit për vitin 2020 dhe i transferohet Bashkisë Durrës, në formën e transfertës së pakushtëzuar.

3. Fondet e mbetura të papërdorura pas përfundimit të procedurave të prokurimit në zbatim të këtij vendimi kthehen në zërin “Fondi për rindërtim” në buxhetin e shtetit.

4. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe